- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;

-
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Preventivi:

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

PER ARTIKUJT MISH KERKESA CILESORE SPECIFIKE DHE TE PERGJITHSHME

Specifikimet Teknike dhe përshkrimi i mallrave që do të prokurohen janë hartuar nga komisioni, për të përcaktuar sa më saktë dhe në mënyrë sa më të plotë objektin e prokurimit dhe për të krijuar kushte për një procedurë të paanshme e të hapur ndërmjet konkurrenteve.

Specifikimet Teknike pershkruajne qarte kerkesat e Entit Prokurues, me qellim percaktimin e standarteve per artikujt ushqimore te detyrueshme per tu zbatuar nga autoriteti kontraktor ne lidhje me cilesine, prodhimin, ambalazhimin, marketimin dhe etiketimin e mallrave qe prokurohen , per te siguruar rritjen e cilesise se ushqimit per grupe te veçanta te konsumatoreve (femije te moshes 6 muaj deri ne 6 vjeç), qe jane nen kujdesin dhe pergjegjesine e Entit qe prokuron keto mallra.

Ne hartimin e specifikimeve teknike teknike per Enti eshte bazuar ne :

- Ligjin Nr 9863 date 28.01.2008”Per Ushqimin”
- Ne standartet Shterore ne fuqi per karakteristikat e produkteve Ushqimore
- Ne VKM Nr.1344 date 10.10.2008”Per miratimin e rregullave per etiketimin e produkteve ushqimore”
- Ne udhezimin e Ministrit te Bujqesise Nr 22 date 25.11.2010”Per kushtet e pergjithshme dhe te veçanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor”

Ne hartimin e specifikimeve Teknike produktet ushqimore jane kategorizuar ne:

- ***Ushqime me origjine jo shtazore***
- ***Ushqime me origjine shtazore***
- Emertimin e plote, njesia e matjes,sasite per çdo artikull jane percaktuar qarte ne

tabelat bashkengjitur fteses per tender.

- Çmimi i ofertes qe do te paraqitet nga secili konkurent duhet te jete çmim i

ofruar per cilesine e pare,pasi produktet ushqimore te prokuruara do te perdoren per ushqyerjen e femijeve te grup-moshes 0-6 vjeç,qe trajtohen ne Kopshtet dhe Çerdhen e Bashkise Librazhd per vitin 2022.

- Artikujt Ushqimor qe do te prokurohen duhet te plotesojne kerkesat dhe parimet

e pergjithshme dhe specifike per higjenen dhe sigurine ushqimore,kerkesat e pergjithshme per cilesine e ushqimeve, etiketimin, origjinen, peshen si dhe kerkesat e pergjithshme dhe specifike per higjenen e mjedisit,personelit dhe e mjeteve te transportit qe do te furnizojne ushqimet e prokuruara.

- Çdo artikull ushqimor duhet te shoqerohet me ***raport analize origjinale*** ose

fotokopje e noterizuar i leshuar nga nje laborator i autorizuar i kontrollit,ose i references,per produktet e ofruara.Raport analiza perkatese duhet te jete te jete sipas llojit te produktit,numrit te Lotit dhe jetegjatesise se produktit dhe te kete lidhje me produktin/mostren e ofruar.Ne kete raport analize duhet te jete shenuar: emertimi i plote i produktit ose nje e dhene tjetere qe lidh kete raport analize me produktin e ofruar.

- Produkti ushqimor kur te levrohet, duhet te jete i shoqeruar me çertifikaten e

origjines dhe flete analize per treguesit e sigurise e cilesise sipas ligjit ne fuqi per ushqimin.

- Te gjithë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike te produktit te

ofertuar/mostres qe perfaqesojne artikullin,duhet te perputhen plotesisht me treguesit e pershkruar ne keto specifikime te hartuara sipas Standartit Shteteror perkates ne fuqi.

Çdo artikull ushqimor duhet te kete etiketen e cila duhet te jete e ngjitur, qartesisht e dukshme dhe e lexueshme.Etiketa duhet te jete ne gjuhen shqipe duhet te permbaje te gjithë elementet qe kane lidhje me cilesine, daten e prodhimit dhe te skadences, marken, dhe gjithë elementet e gjurmueshmerise se nje produkti.

- N.q.s artikulli eshte i mbuluar (amballazhuar) me nje material veshes te gjitha

informacionet e detyrueshme duhet te figurojne mbi kete te fundit,ose etiketa e amballazhit duhet te jete lehtesisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe permbajtja neto,duhet te bjere ne sy qe ne pamje te pare.

N.q.s.gjuha ne etiketen origjinale nuk eshte e pranueshme per konsumatorin,per te cilin ajo eshte e destinuar, duhet te perdoret nje etikete tjeter shtese qe permban informacionin e detyrueshem ne gjuhen shqipe.

Ne rastin kur etiketa eshte zevendesuar apo plotesuar me nje tjeter, shenimet e detyrueshme duhet te jene pike per pike sit e etiketes origjinale

- Frigoriferet e instaluar ne ambientet e operatorit ekonomik,duhet te kene

rregjistrat perkates per monitorimin e temperatures sipas udhezimi te Ministrit te Bujqesise Nr 22 date 25.11.2010”Per kushtet e pergjithshme dhe te veçanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor”

- Automjetet e perdorur per transportin e produkteve duhet te jene te pajisura me

mates temperature (taograf)per gjurmimin e temperutres gjate levizjes se mjetit.

- **PER ARTIKULLIN MISH VIÇI (i fresket).**

Oferta qe do te paraqitet nga secili konkurent duhet te perfshije: Furnizimi me artikullin e mesiper do te jete vetem **MISH VIÇI i FRESKET CIL.PARE ose ekuivalente.**

Çdo sasi mishi e furnizuar(shpatull,kofshe,gjoks) duhet te kete vulen kontrollit veterinar dhe te shoqerohet me çertifikaten veterinare e cilagaranton sigurine e produktit dhe qe verteton se nga kontrolli i kryer kafsha nuk eshte prekur nga semundje qe eshte eshte i sigurtedhe qe se lejon te tregtohet per konsum publik.

KERKESAT CILESORE.

TREGUESIT ORGANO-LEPTIKE

Lloji : Mish viçi i frsket cilesia e pare.Cilesia e pare : Muskultura e zhvilluar

mire. Kockat nuk duken. Ne viçat e vegjel mund te duket pak. Sgavra e legenit dhe veshkat jane te mbuluara me dhjame ne jo me pak se 80% te sipërfaqes.

Pamja e jashtme : Siperfaqja e mishit eshte e mbuluar me nje cipe te holle tharje. Siperfaqja e mishit pas prerjes eshte e laget dhe e ndritshme. Siperfaqja e mishit ne prerje eshte e laget dhe e ndritshme. Lengu del me veshitresi dhe eshte i tejdukshem.

Ngjyra.....Mishi i viçit ne sipërfaqe ka ngjyre roze i çelet. Ngjyra e dhjame ne mishin e viçit eshte e bardhe.

Konsistenca.....Duhet te jete e bute dhe elastike. Gjurma qe formohet nga shtypja e mishit me gisht zhduket menjehere.

Era ...E kendeshme. Mishi nuk duhet te mbaje eren e llojit. Nuk duhet te kete ere te huaj dhe nuance jeshile ne sipërfaqe.

Palca e kockave.....Palca e kockave te mishit te viçit ka ngjyre te verdhe dhe mbush te gjithë kanalit e palces se kockave.

Lengu i mishit pas zierjes.....I tejdukshem, aromatik, ne sipërfaqe duken shtresa ose pika yndyre

Furnizimi i mishit do te behet ne gjysem ose çerek karkase. Karkasa ndahet ne mes te vertebrave kur ndahet ne gjysme, ndersa ndarja ne çerek behet ndermjet brinjës se 12 e 13. Koka veçohet nga trupi ne vertebrën e pare, ndersa kembet tek kupa e gjurit.

Viçi i therur per mish dhe qe do te furnizoje institucionet tona duhet te jete jo me shume se 1 vjeç dhe pesha e gjithë karkases jo me shume se 150 kg. Te mos kete sasi te madhe dhjami, preferohet kofshe e pasme. Furnizimi me mish viçi te jete ne sasine e kerkuar pa te brendeshme dhe pa koke.

Tregtimi i mishit te fresket behet jo me pare se 6 ore nga koha e therjes ne vere dhe dhe jo me shpejt se 12 ore nga koha e therjes ne dimer. Ne çdo njerën prej pjeseve te furnizuara duhet duhet te jete e vendosur qarte e dukshme dhe e lexueshme **vula e kontrollit te sherbimit veterinar** te njesise vendore ku theret kafsha. Çdo sasi te furnizuar te shoqerohet me: **faturen tatimore te shitesit dhe çertifikaten sanitare-veterinare.**

Transporti do te kryhet me mjetet e firmest e specifikuara dhe te pershtateshme per ruajtjen e mishit gjate tranposrtit.

Transporti do të bëhet me mjetet e firmest e specifikuar dhe të përshtatshme për ruajtjen e parametrave të mishit gjatë transportit dhe për të garantuar treguesit cilësorë .

Mishi duhet të thërrë vetëm në thertore të licencuara të cilat plotësojnë standartet.

Mishi ruhet në frigorifer në temperaturë -6° - 0° .

Amballazhimi bëhet me qese sipas kërkesës së Entit dhe çdo gjysëm apo çerek trupi duhet të ketë me patjetër vullenë e kontrollit veterinar.

Kërkesa për artikujt do të merren çdo ditë. Transporti i produkteve ushqimore do të sigurohet nga vete furnizuesi deri në magazinën e ushqimeve të Kopshtë-Çerdhës.

Orari i furnizimit do të jetë në çdo rast nga ora 6^{00} deri në 08^{00} .

Marrja në dorëzim e artikujve ushqimore dhe plotësimi i treguesve cilësorë do të kryhet nga një komision i ngritur me urdher të veçantë nga kryetari i Entit Prokurues

Grafiku i levrimit: Nga data e lidhjes së kontratës , me afat kohor 12 muaj nga nënshkrimi I marrëveshjes kuader. Lëvrimi do të jetë periodik,i përditshëm sipas kërkesave të institucioneve objekt furnizimi

Grafiku i levrimit: 12 muaj nga lidhja e marrëveshjes kuader.

Shënim : Në rastet kur citohet në specifikimet teknike termi “ Cilësia e parë”, ky përcaktim është i barasvlefshëm me termin “ ekuivalente”.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit: 12 muaj .

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi i Artikullit	Njesia	Sasia
	Mish Vici i fresket	kg	2550
	Totali ne leke pa tvsh	leke	
	T.v.sh.(20%)	leke	
I	TOTALI	leke	

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga data e lidhjes se marreveshjes kuader.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutuar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmartjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Oferten ekonomike.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Xhiroja mesatare vjetore per nje periudhe maksimumi deri ne 3(tre) vitet e fundit financiare , duhet të ketë një vlerë te pakten 40 % te vleres se parashikuar te kontrates, pa perfshire vleren e TVSH-se, per te cilin duhet te paraqitet vertetim leshuar nga administrata tatimore. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nqs Operoret Ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale , ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga AK si me lart.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2020 – 2021 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, te ndryshuar.

a. Kapaciteti teknik :

Per te provuar pershtatshmerine me veprimtarine profesionale , kapacitetet teknike dhe profesionale , Autoriteti Kontraktor kerkon:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses te nje ose disa kontrata te meparshme , të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet te jete te minimalisht deri ne 20% e vlerës te kontrates qe po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete OE duhet te paraqese si dëshmi për përvojën e mëparshme,

- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara . (Per kontratat ne sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën përkatëse për prodhim dhe/ose tregtim të produkteve objekt prokurimi, Licence kategoria II.1.A.1: “ Prodhim , perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez”, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit .

Në rastet kur, operatorët ekonomikë nuk kane detyrim ligjor të liçensohen nga QKB, duhet të deklarojne ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit , **ndër të tjera që është i regjistruar në**

regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi **1(nje) automjet i cili duhet të jetë frigoriferik**, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës dhe të shoqëruar me lejen higjieno-sanitare, leje qarkullimi, akt kolaudimi dhe sigurimin e detyrueshëm të mjetit. Në rastin e marrjes me qira kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, te ndryshuar. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do t’i kërkoje ofertuesit të kualifikuar, i pari** dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

2.3.4. Ne respektim dhe zbatim te Rekomandimit te APP dhe Autoriteti Kombetar i Ushqimit me nr. 10181 prot, date 19.11.2018 subjekti ofertues **duhet të paraqesë vetedeklarim**, ku të deklarojë se mjeti frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve objekt i kësaj procedure, kane rregjister perkates per monitorimin e temperatures sipas Udhezimit te Ministrise se Bujqesise nr.22, date 25.11.2010 ” Per kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te higjenes per stabilimentet e ushqimit dhe operatoret e biznesit ushqimor”.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet te operoje duke plotesuar standartet ne fuqi per sigurine ushqimore. Per kete subjekti ofertues **duhet të paraqesë vetedeklarim**, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore

Shenim : Ne respektim dhe zbatim te Rekomandimit te APP dhe Autoriteti Kombetar i Ushqimit me nr. 10181 prot, date 19.11.2018 , AK Bashkia Librazhd ben me dije se Operatori Ekonomik i shpalluar fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin te paraqese dokumentacionin provues , ku te provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kerkesave ligjore.

2.3.6. Ne respektim dhe zbatim te Rekomandimit te APP dhe Autoriteti Kombetar i Ushqimit me nr. 10181 prot, date 19.11.2018 subjekti ofertues **duhet të paraqesë vetedeklarim**, ku të deklarojë se se zbaton dhe garanton kerkesat e ligjit nr.9863 date 28.01.2008 ” Per Ushqimin”, i

ndryshuar per furnizimin /shperndarjen me produkte ushqimore ne ambientet e percaktuar nga AK , si edhe per ruajtjen e higjenes dhe mjedisit , kushteve teknike – teknologjike dhe personelit.

2.3.7.Subjektet ofertuese duhet disponojne te pakten nje pike tregtare te shitjes se produktit te mishit ne territorin e Bashkise Librazhd ne pronesi ose me qera , te pasqyruar ne ekstraktin historik ne QKB.

Shenim : Njesia e Prokurimit , ka percaktuar si kriter kualifikimi:

- Disponimi i te pakten nje pike tregtare te shitjes se produktit te mishit ne territorin e Bashkise Librazhd ne pronesi ose me qera , te pasqyruar ne ekstraktin historik ne QKB per arsyet e meposhteme :

Bordi i Prinderve i kopshteve dhe cerdhes se Qytetit te Librazhdit kane kerkuar qe furnizimi me mish te behet ne nje nga subjektet qe tregtojne ne territorin e Bashkise se Librazhdit , per shkak te cilesise shume te mire te ketij produkti si edhe per faktin qe cilesia e mishit kontrollohet dhe verifikohet nga Sektori i Sherbimit Veterinar ne Bashkine Librazhd . Per kete arsye eshte percaktuar dhe argumentuar qe te vendoset ky kriter kualifikimi edhe per vete faktin qe prinderit paguajne kuotat e ushqimit te femijeve . Sa me lart ne baze te ketij fakti kane edhe te drejten legjitime te percaktojne edhe cilesine dhe origjinen e produkteve qe ushqehen femijet e tyre, bazuar ne parimin e pjesmarrjes ne vendimmarrje dhe sigurise ushqimore. Theksojme faktin qe kërkesa që operatorët ekonomikë te disponojne te pakten nje pike tregtare te shitjes se produktit te mishit ne territorin e Bashkise Librazhd, nuk ka si qellim të sjellë kufizimin e pjesëmarrjes së OE, ofertues të mundshëm, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë qytetit të Librazhdit, por Bordi i Prinderve kane te drejten legjitime te percaktojne cilesine dhe origjinen e produkteve qe ushqehen femijet e tyre .

3. Operatori ekonomik duhet te paraqese :

3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, sipas standardit nderkombetar ISO 9001 ose ekuivalent ose te perditesuar.

Çertifikata duhet te jete e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat e mësipëme kërkohen të jenë të vlefshme.

Ne zbatim te nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

Shenim : Nqs cilesia e mallrave te levruar nga operatori ekonomik i shpallur fitues nuk eshte sipas specifikimeve teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit , atehere OE duhet te zevendesoje mallrat objekt prokurimi me specifikimet e kerkuara .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ne respektim te nenit 36, 37 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalent”.

Sqarim per ofertuesit : Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,i ndryshuar, neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021, te ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do t’i kërkoje ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.****

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit	NIPT –i	Përqindja nënkontraktimit	e	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
------------------------	---------	---------------------------	---	---

të propozuar				• nformacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik
ktet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik				
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et	

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të

mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

